



MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

Republika e Shqipërisë — Zgjedhjet Parlamentare, 23 Qershor 2013

DEKLARATË E GJETJEVE DHE KONKLUZIONEVE PARAPRAKE

Tiranë, më 24 Qershor 2013 –Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (OSBE AP) dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE).

Roberto Batelli (Slloveni) është emëruar si Koordinator Special, nga Shefi i Zyrës së OSBE-së për të drejtuar misionin e vëzhguesve afatshkurtër të OSBE-së. Luca Volontè (Itali) kryesoi delegacionin e APKE-së. João Soares (Portugali) kryesoi delegacionin e AP-së të OSBE-së. Conny McCormack (SHBA) është Drejtuese e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) të OSBE/ODIHR-it, që filloi aktivitetin më 15 Maj 2013.

Vlerësimi u bë për të përcaktuar pajtueshmërinë e zgjedhjeve me angazhimet e OSBE-së dhe standardet për zgjedhje demokratike të Këshillit të Evropës, si dhe detyrimet ndërkombëtare dhe legjisllacionin vendas të Shqipërisë. Kjo deklaratë e gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake është hartuar përpara përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga ecuria e fazave fundit të procesit zgjedhor, duke përfshirë numërimin e votave, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e ankesave dhe apelimeve të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. Pothuajse tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor, OSBE/ODIHR-i do të nxjerrë një raport të plotë përfundimtar, ku do të përfshihen rekomandime për përmirësime të mundshme. AP e OSBE-së do të paraqesë raportin e saj në Komisionin e Përhershëm në Seancën Vjetore më 29 qershor 2013, në Stamboll. Delegacioni i APKE-së do të paraqesë raportin e tij në tetor 2013.

KONKLUZIONET PARAPRAKE

Zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit në Republikën e Shqipërisë ishin konkurruese me pjesëmarrje aktive të qytetarëve gjatë gjithë fushatës dhe respekt të mirëfilltë për liritë themelore. Megjithatë, atmosfera e mosbesimit midis dy forcave të mëdha politike njollosoi klimën zgjedhore dhe kërcënoi administrimin e të gjithë procesit zgjedhor. Votimi vijoi mirë, megjithë parregullsitë procedurale, por numërimi u vonua në shumë zona.

Mospërputhjet e hershme e të përsëritura dhe mosbesimi reciprok i vazhdueshëm ndërmjet partive politike kryesore çënoi punën e administrimit të zgjedhjeve dhe kërcënoi ecurinë e qetë të zgjedhjeve. Pasi partitë opozitare bojkotuan Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shkarkimit të debatueshëm të njërit prej anëtarëve, KQZ-ja e zhvilloi pjesën e mbetur të punës së saj pa kuorumin e nevojshëm për të miratuar vendime kyçe. Përshtypja se KQZ-ja veproi në mënyrë politike u përforcua vendimi i saj për të rikompozuar komisionet zgjedhore të niveleve më të ulëta.

Kodi zgjedhor u ndryshua gjerësisht në korrik 2012 me mbështetjen e partive të mëdha politike, gjë që përmirësoi kuadrin zgjedhor në mënyrë të gjithanshme. Këto ndryshime marrin parasysh një sërë rekomandimesh të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) i Këshillit të Evropës. Kuadri ligjor që rregullon zgjedhjet parlamentare ofron përgjithësisht një bazë të shëndoshë për zhvillimin demokratik të zgjedhjeve. Megjithatë,

besimi i publikut në procesin zgjedhor u çënuar, sepse implementimi dhe zbatimi i ligjit mungoi në një sërë aspektesh nga të gjithë palët kryesore të interesit.

Në mungesë të vendimit të KQZ-së për ndarjen e mandateve në katër zonat zgjedhore, vendimi i mëposhëm i parlamentit për këtë çështje ishte në kundërshtim me parimin e procesit të rregullt ligjor dhe barazinë e votës. Gjykata Kushtetuese e refuzoi juridiksionin për një ankesë që kundërshtonte vendimin e parlamentit.

Gjashtëdhjetë e gjashtë partitë politike dhe dy kandidatë të pavarur (të propozuar nga zgjedhësit) u regjistruan për të konkurruar në një proces gjithëpërfshirës që i ofroi zgjedhësve një zgjedhje të mirëfilltë. Shumica e partive politike të regjistruara u bashkuan me njërin nga dy koalicionet zgjedhore të drejtuara nga Partia Demokratike (PD) ose Partia Socialiste (PS).

Kandidatët u angazhuan aktivisht në një fushatë të ethshme. Klima e fushatës ishte përgjithësisht paqësore, me vetëm pak incidente të dhunshme të izoluara.¹ Si një zhvillim pozitiv, partitë hartuan dhe promovuan platforma programatike dhe u angazhuan në debate politike të rëndësishme. Megjithatë, ndonjëherë, akuzat reciproke midis dy partive më të mëdha e largonin vëmendjen nga thelbi i fushatës.

Rastet e zbehjes së vazhdueshme të kufijve midis institucioneve shtetërore dhe interesave partiake, bien në kundërshtim me pikën 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 dhe pikën I.2.3 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias. Pretendimet për blerje votash dhe presioni mbi punonjësit të sektorit publik, ku përfshihen rastet e pjesëmarrjes së detyruar në tubime dhe shkarkim nga puna, janë vlerësuar nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it si të besueshme, kanë ndikuar negativisht në klimën para-zgjedhore. Rregullore për financimin e fushatës nuk ofruan transparencë të mjaftueshme gjatë periudhës së fushatës.

Përgatitjet teknike për zgjedhjet ishin të përshtatshme, pavarësisht disa mangësive të konstatuara, veçanërisht në mosrespektimin e një sërë afatesh ligjore. Pati organizim të vonuar të mbledhjeve dhe një paraqitje e paplotë e vendimeve të KQZ-së në faqen e internetit të KQZ-së, në kundërshtim me ligjin. Megjithatë, partitë dhe media u informuan dhe morën pjesë në mbledhjet e KQZ-së, që ishin të hapura për publikun dhe transmetoheshin në internet (online). KQZ-ja ishte plotësisht bashkëpunuese me vëzhguesit ndërkombëtarë.

Përgjithësisht, ekzistonte besimi në cilësinë e listave të zgjedhësve, por edhe disa shqetësime të shprehura kryesisht nga partitë më të vogla politike. Numri i zgjedhësve pa një adresë të plotë u reduktua me rreth 35 përqind përpara këtyre zgjedhjeve, që përmirësoi me tej saktësinë. Listat e zgjedhësve u vunë në dispozicion për rishikim dhe zgjedhësit mund të verifikonin dhe korrigjonin të dhënat e tyre. Rreth 139 kryetarë bashkie u gjobitën për shkak të mosrespektimit të plotë të detyrimit të tyre ligjor për të informuar KQZ-në për numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjet e qendrave të votimit.

Klima mediatike ishte pluraliste gjatë gjithë fushatës dhe ofroi larmishmëri në përmbajtje, gjë që i mundësoi zgjedhësit të bëjnë një zgjedhje të ndërgjegjësuar. Megjithatë, pavarësia editoriale, u çënuar nga ndikimi politik. Transmetuesi televiziv publik u ofroi partive më të mëdha mbulim mediatik të barabartë, por ishte më pozitiv në qasje kundrejt partisë në pushtet. Media e monitoruar nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nuk e përmbushi detyrimin ligjor për t'i siguruar partive më të vogla sasinë e specifikuar të mbulimit informativ. Krijimi i vonuar i Bordit të Monitorimit të Medias dhe mungesa e kolegjalitetit e reduktoi efektivitetin e tij. KQZ-ja miratoi një vendim të

¹ Gjithashtu, më 23 Qershor, u realizuan katër zgjedhje të pjesshme për qeverisjen vendore. OSBE/ODIHR-i ndoqi këto zgjedhje vetëm për pjesën që ato ndikuan zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare.

debatueshëm që nënkuptoi një kërkesë për transmetuesit për të transmetuar materialin e fushatës të përgatitur nga subjektet zgjedhore në edicionet e tyre informative gjë që shkeli lirinë editoriale.

Kandidatet femra përfituan mbulim të skajshëm mediatik që reflekton çështjet e përhershme të pjesëmarrjes së grave në jetën politike. Ndërsa partitë politike përmbushën kërkesën e tyre për të përfshirë të paktën 30 për qind të secilës gjini në anëtarësinë e përgjithshme të Komisioneve e Zonave të Administrimit Zgjedhor, përfaqësimi i femrave në Komisionet e Qendrave të Votimit ishte vetëm 18 për qind. Detyrimi për kuotën gjinore në listat e kandidatëve nuk u përmbush nga PD-ja, PS-ja dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) në një sërë zonash zgjedhore, gjë që rezultoi në gjoba megjithëse listat që nuk e zbatonin këtë detyrim u regjistruan.

Palëve të interesit nuk iu siguruan masa korigjuese ligjore efikase dhe proces të rregullt ligjor në mënyrë të mjaftueshme për të zgjidhur ankesat lidhur me zgjedhjet. Në rastet më të rëndësishme, organet vendimmarrëse refuzuan shqyrtimin e ankimeve ose tejkaluan juridiksionin e tyre. Subjektet zgjedhore rrallëherë përdorën mekanizmat e zgjidhjes së konflikteve zgjedhore të vëna në dispozicion.

Kodi Zgjedhor i dha KQZ-së detyrën të testonte dy sisteme të reja teknologjike për zgjedhjet: numërimin elektronik dhe verifikimin elektronik të zgjedhësit. Megjithatë, KQZ-ja shkeli një sërë afatesh ligjore dhe nuk miratoi rregulloret e nevojshme, duke bërë kështu të pamundur implementimin e tyre të suksesshëm. KQZ-ja anuloi zyrtarisht të dy sistemet pilote në javën përpara ditës së zgjedhjeve.

GJETJET PARAPRAKE

Konteksti

Zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit u konsideruan gjerësisht si një test i rëndësishëm për zhvillimin demokratik të Shqipërisë dhe aspiratat e saj drejt aderimit në Bashkimin Evropian.

Klima politike ka qenë e tensionuar që nga zgjedhjet e fundit parlamentare në vitin 2009 që rezultoi në përfaqësim pothuajse të barabartë të koalicioneve të drejtuara nga Partia Demokratike (PD) dhe Partia Socialiste (PS), përkatësisht me 70 dhe 66 mandate. Katër mandatet e mbetura u fituan nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), e cila më pas iu bashkua koalicionit qeverisës të drejtuar nga PD-ja.

Në vijim të largimit të LSI-së nga koalicioni qeverisës në mars 2013, parlamenti shkarkoi anëtarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të propozuar nga LSI-ja i cili u zëvendësua nga një përfaqësues i Partisë Republikane (PR) nga koalicioni qeverisës. Kjo çoi në dorëheqjen e tre anëtarëve të propozuar nga opozita. Parlamenti nuk ka miratuar dorëheqjet, meqenëse partitë nuk kanë emëruar zëvendësuesit e tyre.

Klima politike u karakterizua nga polarizim të zgjatur ndërmjet PD-së dhe PS-së dhe mosbesimi i partive të tjera kundrejt tyre. Shumica e partive politike të regjistruara iu bashkua njërit prej dy koalicioneve për zgjedhjet që po afroheshin. 25 parti ishin në Aleancën për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim, të drejtuar nga PD-ja e Kryeministrit Sali Berisha dhe 37 parti iu bashkuan Aleancës për Shqipërinë Evropiane, të drejtuar nga PS-ja dhe udhëheqësit të saj Edi Rama.

Kuadri Ligjor dhe Sistemi Zgjedhor

Kuadri ligjor që rregullon zgjedhjet parlamentare, nëse zbatohet në mënyrë të plotë dhe efektive, përgjithësisht siguron një bazë të shëndoshë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Besimi i

publik në procesin zgjedhor u cënua, sepse implementimi dhe zbatimi mungoi në një sërë aspektesh nga të gjithë palët kryesore të interesit.

Kodi zgjedhor u ndryshua gjerësisht në korrik 2012 me mbështetjen e partive politike kryesore, që përmirësoi në mënyrë të gjithanshme kuadrin zgjedhor. Këto ndryshime marrin parasysh një sërë rekomandimesh të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) i Këshillit të Evropës, duke përfshirë përmirësime thelbësore, në procesin e përzgjedhjes së komisionerëve, një proces i përmirësuar për hartimin e listës së zgjedhësve, një proces i thjeshtuar për regjistrimin e kandidatëve, si dhe akses më të barabartë në media dhe fondet publike për financimin e fushatës zgjedhore. Kodi Penal i ndryshuar në mars 2012 krijoi vepra të reja penale zgjedhore dhe rriti dënimet për veprat penale zgjedhore ekzistuese. Megjithëse afatet e burgimit për shpifje dhe përgojime u shfuqizuan, ato mbesin vepra penale.

Megjithatë, disa përmirësime e dobësuan kuadrin ligjor, duke përfshirë mekanizma të zbatimit të ligjit më pak të rrepta për mosrespektimin e kuotës gjinore për listat e kandidatëve dhe një dispozitë më të butë për përdorimin e nëpunësve publikë për qëllime fushate. Shumë rekomandime mbi aspektet thelbësore mbeten të patrajtuara, ku përfshihen masa për të rritur paanshmërinë e komisioneve zgjedhore, të drejtat e kandidatëve të pavarur, transparenca mbi financimin e fushatës; si dhe zgjidhja efektive e konflikteve zgjedhore. Legjislacioni nuk rregullon apo penalizon në mënyrë të përshtatshme keqpërdorimin e burimeve administrative, duke përfshirë nëpunësit publikë dhe zyrtarët e përfshirë në fushatë. Zbatimi proaktiv i dispozitave për zhvillimin e parregullt të fushatës, duke përfshirë blerjen e votave, është i dobët. Përveç kësaj, mekanizmave të ankimit të niveleve më të ulëta të komisioneve zgjedhore u mungon qartësia në lidhje me juridiksionin dhe procesin e zgjidhjes së konflikteve.

Të 140 deputetët e Kuvendit njëdhomësh (Parlamentit) zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare në një sistem proporcional, me 12 zona zgjedhore shumëëmërore që i korrespondojnë qarqeve administrative të vendit. Partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e pavarur mund të konkurrojnë në zgjedhje me lista të mbyllura të kandidatëve të dorëzuara nga partitë për çdo zonë. Partitë që marrin të paktën tre përqind dhe koalicionet që marrin të paktën pesë përqind të votave të vlefshme në një zonë kualifikohen për ndarjen e mandateve.

Numri i mandateve për çdo qark shkon nga 4 në 32. Bazuar në statistikat e shpërndarjes së deritanishme të popullsisë paraqitur nga Ministria e Brendshme (MB), KQZ-së i kërkohet të llogarisë numrin e mandateve për zonë dhe t'ia paraqesë atë parlamentit për miratim.² Megjithëse është një përllogaritje teknike, KQZ-ja ishte e ndarë politikisht dhe e paaftë të miratojë ndarjen e mandateve. Në mungesë të një propozimi nga KQZ-ja, parlamenti e mori vendimin dhe e bëri shpërndarjen e mandateve në bazë të statistikave të popullsisë të vitit 2009 (në vend të atyre të vitit 2013), e cila ishte në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor dhe barazisë së votës.³

Administrimi i Zgjedhjeve

Zgjedhjet u administruan nga një sistem administrimi me tre nivele, të përbërë nga KQZ-ja, 89 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të) dhe 5.508 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV-të). Votat u numëruan në 89 Vende të Numërimit të Votave (VNV-të), një për secilën Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ). Vetëm KQZ-ja është një organ i përhershëm.

² Numri i mandateve caktuar për çdo Qark duhet të bazohet mbi numrin e banorëve.

³ Dy mandate duhet të kishin ndryshuar qark sipas statistikave të deritanishme të popullsisë: qarku i Beratit dhe i Korçës duhet të kishin një mandat më pak dhe qarku i Durrësit dhe i Tiranës secili një mandat më tepër. Kjo është në kundërshtim me pikën 7.3 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990, ku shtetet pjesëmarrëse angazhohen t'u garantojnë qytetarëve të tyre të drejtën e votës.

Komisionet zgjedhore në të gjitha nivelet kanë shtatë anëtarë dhe përbëhen nga personat e emëruar nga partitë politike në bazë të përfaqësimit të tyre në Parlament. Partitë politike e përmbushën detyrimin e tyre për përfshirjen e të paktën 30% të përfaqësuesve nga secili gjini në anëtarësinë e përgjithshme të KZAZ-ve. Asnjë detyrim ligjor nuk është parashikuar për KQV-të dhe grupet e numërimit të votave.

Shkarkimi nga detyra dhe zëvendësimi nga Parlamenti i anëtarit të KQZ-së nuk ndoqi një proces të rregullt ligjor.⁴ Pas dorëheqjes të mëpasshme të anëtarëve të KQZ-së të emëruar nga PS dhe Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) në muajin prill, KQZ-ja funksionoi vetëm me katër anëtarë.⁵ Partitë politike nuk arritën të gjejnë një zgjidhje. Kjo e pengoi KQZ-në të rregullonte aspekte të procesit zgjedhor në një mënyrë ligjore për sa i përket procedurës, meqenëse disa vendime kërkonin miratim me një shumicë të cilësuar prej pesë votash. Përfaqësuesit e PS që nuk kanë të drejtë vote në KQZ vunë herë pas here në dyshim ligjshmërinë e vendimeve të KQZ-së të miratuara me katër vota, megjithëse, për shumicën e rasteve, nuk shkuan gjer në kundërshtimin e ligjshmërisë të vendimeve të tilla. Një vendim i debatueshëm i KQZ-së, si në lidhje me procedurën ashtu edhe në lidhje me përmbajtjen ishte miratimi i rregullave për hedhjen e shortit për përcaktimin e renditjes së kandidatëve në fletën e votimit. Vendimi, që kërkonte një shumicë të cilësuar, u miratua vetëm me katër vota.⁶ Për më tepër, këto rregulla u ndryshuan disa ditë më vonë duke i lejuar KQZ-së të ndryshojë renditjen e partive në fletën e votimit pas hedhjes së shortit, gjë që përbën një shkelje thelbësore të nenit 98.3 të Kodit Zgjedhor.⁷

Përgatitjet teknike për zgjedhjet ishin të përshtatshme, përveç disa mangësive të evidentuara, veçanërisht mos-respektimi i një sërë afatesh ligjore. Edhe përpara se KQZ-ja të funksiononte me vetëm katër anëtarë, ajo nuk miratoi rregulloret e nevojshme për të plotësuar Kodin Zgjedhor, duke përfshirë miratimin e rregullave të brendshme të procedurave 60 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, siç përcaktohet me ligj. Rregulloret e miratuara në zgjedhjet e mëparshme nuk u ndryshuan me qëllimin që të përputheshin me ndryshimet e vitit 2012 në Kodin Zgjedhor. Pati organizim të vonuar të mbledhjeve dhe një paraqitje e paplotë e vendimeve të KQZ-së në faqen e internetit të KQZ-së, në kundërshtim me ligjin.⁸ Megjithatë, partitë dhe Media u informuan dhe morën pjesë në mbledhjet e KQZ-së, të cilat ishin të hapura për publikun dhe transmetoheshin online (në internet). KQZ-ja ishte plotësisht bashkëpunuese me vëzhguesit ndërkombëtarë. KQZ-ja zhvilloi trajnime për zyrtarët zgjedhorë, të cilat MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i vlerësoi në mënyrë pozitive, megjithëse efektiviteti i tyre ishte i kufizuar për shkak të ndryshimeve të vonuara në komisionet e nivelit më të ulët. Përpara ditës së zgjedhjeve KQZ transmetoi reklama informative për zgjedhësit, duke përfshirë reklama që kishin objekt zgjedhësit për herë të parë dhe zgjedhësit me nevoja të veçanta.

Megjithëse KZAZ-të përgjithësisht gëzuan besimin e palëve të interesit në zgjedhjeve dhe punuan në mënyrë kolegjiale, një numër i konsiderueshëm i KZAZ-ve ishin të ndarë sipas bindjeve politike në marrjen e vendimeve. Pas krijimit fillestar të KZAZ-ve në 25 mars, KQZ-ja zëvendësoi të gjithë anëtarët e emëruar nga partia e dytë më e madhe e opozitës, PBDNJ në të 89 KZAZ-të me anëtarë të PR, “për shkak të rrethanave të reja të krijuara në përbërjen e grupeve të shumicës dhe opozitës

⁴ Neni 18 i Kodit Zgjedhor përshkruan procedurën sipas të cilës Parlamenti mund të shkarkojë nga detyra një anëtar të KQZ-së vetëm në bazë të propozimit ose njoftimit nga KQZ-ja dhe jep një listë shteruese arsyesh për ndërprerjen e para kohe të një mandati, ku nuk përfshihet rikompozimi i Parlamentit. Neni 12.2.ë të Kodit Zgjedhor nuk është listuar si një arsye për shkarkim në bazë të nenit 18.

⁵ Si PS-ja dhe LSI-ja përdorën të drejtën e tyre ligjore për të caktuar në KQZ anëtarë që nuk kanë të drejtë vote dhe përfaqësuesit e tyre morën pjesë aktivisht në mbledhjet e KQZ-së.

⁶ Neni 98.1 i Kodit Zgjedhor.

⁷ Vendime të tjera të KQZ-zë që kërkojnë pesë vota përfshijnë miratimin e fletëve të votimit dhe rendin e numërimit të fletëve të votimit në zonat ku do të zhvillohen si zgjedhjet parlamentare ashtu edhe ato të pjesshme të qeverisjes vendore.

⁸ MVZ i OSBE/ODIHR-it konstatoi se të paktën 159 vendime nuk ishin vënë në faqen e internetit të KQZ-së, ku përfshiheshin 139 vendime që kishin të bënin me gjobat ndaj kryetarëve të bashkive për çështje që lidheshin me regjistrimin e zgjedhësve. (Shiko rubrikën mbi Regjistrimin e zgjedhësve).

parlamentare”. Ky justifikim nuk është listuar ndërmjet arsyeve për shkarkim në bazë të nenit 32 të Kodit Zgjedhor.⁹ Partitë politike zëvendësuan një numër të madh anëtarësh të KZAZ-ve sipas dëshirës. Ato vazhduan me këtë praktikë gjer disa ditë para zgjedhjeve, pasi komisionet ishin trajnuar tashmë. Këto zëvendësime të vazhdueshme ngritën dyshime në lidhje me paanshmërinë e KZAZ-ve dhe potencialisht reduktuan efektivitetin e tyre.¹⁰

Krijimi i Qendrave të Votimit (KQ-ve) në ambiente private mbetet një çështje e kontestueshme. Përveç kësaj KQZ-ja ndryshoi vendndodhjen e rreth 90 KQ-ve pasi njoftimet u ishin dërguar zgjedhësve dhe për arsye ligjore të diskutueshme.¹¹ Të gjitha partitë politike që e kishin këtë të drejtë, vazhduan të dorëzojnë emërimet për KQV-të dhe grupet e numërimit të votave pas afateve ligjore dhe të kërkojnë ndryshime për të zëvendësuar një numër të personave të emëruar prej tyre gjer në ditën e zgjedhjeve. Këto zëvendësime shkaktuan pasiguri, ndërprerje në përgatitjet, dhe në rastin e KQV-ve, shkelën ligjin.

Teknologjitë e reja për zgjedhjet

Kodi Zgjedhor i caktoi detyrën KQZ-së të testonte dy teknologji të reja zgjedhore për këto zgjedhje: Sistemin elektronik të numërimit (SEN-në) në qarkun e Fierit dhe Sistemin elektronik të verifikimit të zgjedhësve (SEV-në) në qarkun e Tiranës. Përgatitja për këto dy projekte pilote u zgjat përtej afateve ligjore dhe e bëri të pamundur implementimin e suksesshëm të tyre. Përveç kësaj, KQZ-ja nuk miratoi të gjitha rregulloret e duhura, të nevojshme për testimin dhe implementimin e sistemit. Vendimi i KQZ-së që të ruante modelin (dizajnin) e fletës së votimit, së bashku me numrin e madh të partive kandidatë në fletën e votimit, e bënë të pamundur implementimin e SEN-it me hardware-in (pajisjen kompjuterike) të zgjedhur. Vendimi i KQZ-së për të ndërprerë projektin pilot SEN u mor më 17 qershor. Përveç kësaj, përgatitjet për SEV-in u dëmtuan nga mungesa e një kriteri të qartë për suksesin e testit, siç u demonstrua në një test publik. Në 18 qershor KQZ-ja anuloi gjithashtu zyrtarisht implementimin e sistemit SEV për shkak të numrit të problemeve të paparashikuara të identifikuar gjatë testimit në lidhje me sigurinë e sistemit dhe vonesat e mundshme gjatë votimit.¹² Gjatë gjithë këtij procesi mungoi planifikimi i detajuar dhe në kohë i projektit, bashkëpunimi i grupeve të interesit dhe edukimi i zgjedhësve, aspekte të nevojshme për të prokuruar, testuar, trajnuar në lidhje me të, dhe implementuar këtë sistem kompleks elektronik.

Regjistrimi i Zgjedhësve

Sipas KQZ-së, 3,271,885 zgjedhës u përfshinë në listat e zgjedhësve (LZ).¹³ Zgjedhësit që banojnë jashtë shtetit ngeleshin në listën e zgjedhësve në adresën e fundit ku ishin regjistruar. Rreth 20 qendra votimi u ngritën në burgje dhe në qendrat e paraburgimit. Gjatë 40 ditëve përpara ditës së votimit zgjedhësit mund të futeshin në listat e zgjedhësve vetëm me vendim gjykate; MVZ e OSBE/ODHIR-it konstatoi se ishin dorëzuar pak raste. LZ-të janë nxjerrë nga baza elektronike e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile të mbajtur nga MB, ku kryetarët e bashkive kanë

⁹ Neni 32 i Kodit Zgjedhor ofron një listë shteruese arsyesh për shkarkimin para kohe nga detyra të anëtarëve të KZAZ-ve, të cilat nuk përfshijnë rikompozimin e parlamentit. Ndërsa një ankim u dorëzua nga PBDNJ-ja që kundërshtonte shkarkimin nga KQZ-ja të të gjithë anëtarëve të saj nga KZAZ-të, ky ankim më pas u tërhoq.

¹⁰ Rreth 169 zëvendësime në anëtarët e KZAZ-ve përfaqësojnë rreth 22 për qind të numrit të tyre total. OSBE/ODHIR-i më parë ka rekomanduar që të shfuqizohet mundësia e partive politike për të tërhequr anëtarët e KZAZ-ve, megjithatë vetëm një dispozitë e ngjashme në lidhje me tërheqjen e anëtarëve të KQV-ve u shfuqizua gjatë rishikimit të Kodit Zgjedhor më 2012.

¹¹ Neni 64.2 i Kodit Zgjedhor kërkon “forcë madhore” si shkak për ndryshim të vonshëm të vendndodhjes së qendrave të votimit. Dy raste që kundërshtonin këto ndryshime të vonshme u dorëzuan në Kolegjin Zgjedhor dhe njëra u pranua.

¹² Më 20 qershor, PS dorëzoi një kërkesë tek Prokuroria e Përgjithshme për të ndjekur penalisht të katër anëtarët e KQZ-së dhe nëpunësit përgjegjës të KQZ-së në bazë të nenit 248 të Kodit Penal, për shpërdorim të detyrës publike, për anulimin e projektit pilot SEV.

¹³ KQZ-ja raportoi 949 zgjedhës më shumë në listat e zgjedhësve në krahasim me numrin e publikuar nga MB.

përgjegjësinë të verifikojnë saktësinë e LZ-ve dhe kanë detyrimin të njoftojnë KQZ-në mbi numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e qendrave të votimit. Rreth 139 kryetarë bashkie u gjobitën për mos-respektim të plotë të detyrimit ligjor për të njoftuar KQZ-në për numrin e votuesve dhe vendndodhjen e qendrave të votimit.

Në përgjithësi ekzistonte besim në lidhje me saktësinë dhe cilësinë e LZ-ve, por edhe disa shqetësime që u shprehën kryesisht nga partitë më të vogla politike. Megjithëse LZ-të ishin afishuar për publikun, vëzhguesit ndërkombëtarë konstatuan si disa vonesa në afishimin e LZ-ve, ashtu edhe vendosjen e tyre në vende të pa-aksesueshme. Gjithashtu, zgjedhësit mund t'i kontrollonin detajet e tyre online. Megjithatë, efektiviteti i këtyre masave mund të ishte përmirësuar nëpërmjet informacionit më të zgjeruar për zgjedhësit.¹⁴ Ligji e detyron MB-në të heqë nga LZ-të të 1,130 qytetarët që kanë mbushur moshën 100-vjeçare, si një masë për të hequr zgjedhësit që mund të kishin vdekur, dhe i detyroi ata të aplikonin për ri-përfshirje në listë. 380 persona e bënë këtë. Në disa raste, bashkëbiseduesit e ngritën çështjen e zgjedhësve të vdekur, të cilët ishin ende në listat e zgjedhësve. MB-ja deklaroi se numri i zgjedhësve pa adresë të plotë ishte reduktuar në periudhën midis shkurtit dhe majit me rreth 35%, nga 542,808 në 348,346 persona, gjë e cila e përmirësoi më tej saktësinë dhe cilësinë e LZ-ve.

Kandidatët përdorën të drejtën e tyre për të marrë kopje të LZ-ve dhe ndihmuan zgjedhësit për të verifikuar të dhënat e tyre, duke afishuar gjithashtu LZ-të në zyrat e partive. Siç kërkohet me ligj, KQZ-ja caktoi dy auditë, (të propozuar nga PS dhe PD), për të verifikuar cilësinë e listës së zgjedhësve. Gjetjet dhe rekomandimet e tyre të veçanta u paraqitën në KQZ dhe u dërguan në MB. Megjithatë, kjo u bë shumë vonë, për të patur një ndikim në saktësinë e LZ-ve.

Regjistrimi i Kandidatëve

Gjashtëdhjetë e gjashtë parti politike dhe dy kandidatë të pavarur u regjistruan si konkurrentë në një proces gjerësisht gjithëpërfshirës që u ofroi zgjedhësve një zgjedhje të mirëfilltë. KQZ-ja fillimisht regjistroi 64 parti politike dhe 2 kandidatë të pavarur, ndërsa 6 parti si dhe 5 kandidatë të pavarur u refuzuan. Nga gjashtë partitë që e apeluan vendimin, dy e fituan apelin dhe u regjistruan nga gjykata.¹⁵ KQZ-ja, pasi u dha partive një mundësi për të bërë korrigjime, miratoi të gjitha listat e kandidatëve, me një total prej 7,149 kandidatësh, ku përfshihen 2,753 femra. Sipas Kodit Zgjedhor, përpara regjistrimit, kandidatët duhet të japin dorëheqjen nga postet publike të nivelit të lartë. Një kandidat nuk e bëri këtë.¹⁶

Çdo listë kandidatësh ka detyrimin ligjor të përfshijë të paktën një mashkull dhe një femër në tre vendet e para dhe duhet të përbëhet të paktën nga 30% nga secila gjini. Për të përmbushur këtë kuotë, shumë parti përfshinë femra në vendet e fundit të listës, në pozicione ku nuk mund të fitohej. Dispozita që detyronte KQZ-në të mohonte regjistrimin për listat që nuk zbatonin këtë detyrim u shfuqizua në 2012, duke reduktuar kështu efikasitetin e detyrimit për kuotën gjinore. KQZ-ja vendosi gjoba për të tre partitë më të mëdha parlamentare, (PD; PS dhe LSI) sepse nuk respektonin kuotën gjinore në katër, gjashtë dhe katër zona përkatësisht.¹⁷ Megjithëse KQZ-ja u dha këtyre

¹⁴ MVZ e OSBE/ODIHR-it vuri re se zgjedhësit në më shumë se gjysmën e KZAZ-ve nuk ishin njoftuar as për vendndodhjen e QV-së së tyre dhe as për numrin e tyre në LZ, siç kërkohet me ligj.

¹⁵ Në të dy rastet për të cilat vendimi u hodh poshtë nga Kolegji Zgjedhor, KQZ-ja aplikoi kërkesa për dokumentacion jashtë kriterëve ligjore për regjistrimin e partive. Në një rast, KQZ-ja refuzoi regjistrimin e një partie sepse nuk kishte një shkurtim (akronim) zyrtar. Gjatë apelit, gjykata e aprovoi vendimin e KQZ-së. Rastet e tjera të regjistrimit të refuzuar duket se kishin bazë ligjore të shëndoshë.

¹⁶ Shiko nenin 63.4 të Kodit Zgjedhor. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, zyrtar i lartë i administratës publike, ishte kandidat në listën e PD për Tiranën dhe dha dorëheqjen vetëm më 19 Qershor.

¹⁷ Në vitin 2012, gjoba për parregullsi në lista, u rrit nga 30 000 Lekë (215 Euro) në 1 milion Lekë (7,120 Euro) (afërsisht 1 Euro = 140 Lekë).

partive një mundësi të korrigjonin shkeljet në lidhje me kuotën gjinore, ato zgjodhën të mos ta bëjnë këtë, dhe listat që nuk e zbatonin detyrimin u regjistruan.¹⁸

Klima Zgjedhore dhe Financimi i Fushatës

Kandidatët u angazhuan aktivisht në një fushatë të ethshme. Klima e fushatës ishte përgjithësisht paqësore, me vetëm pak incidente të dhunshme të izoluar.¹⁹ Si një zhvillim pozitiv, partitë hartuan dhe promovuan platforma programatike dhe u angazhuan në debate politike të rëndësishme. Megjithatë, ndonjëherë, akuzat reciproke midis dy partive më të mëdha e largonin vëmendjen nga thelbi i fushatës.

Liritë themelore u respektuan dhe të gjithë kandidatët patën mundësinë të konkurrojnë lirisht. Partitë politike filluan të bënin fushatë aktive përpara fillimit të fushatës zyrtare në 24 maj, dhe figurat kryesore politike dhe zyrtarët e lartë të qeverisë udhëtuan në të gjithë vendin për të prezantuar kandidatët në tubime të shkallës së gjerë. Partitë parlamentare si dhe partia Fryma e Re Demokratike (FRD)²⁰ organizuan tubime të gjera dhe koncerte dhe përdorën gjerësisht postera dhe banera. Partitë e tjera bënë takime të shkallës më të vogël dhe shpërndanë fletëpalosje vetëm në zonat ku prisnin një nivel më të lartë mbështetjeje. Të gjitha partitë e përdorën median sociale gjerësisht gjatë gjithë fushatës. Ndërsa disa kryetarë bashkie i përmbushën detyrimet e tyre ligjore për të ofruar hapësirë për reklamë me anë të një vendimi zyrtar, të tjerë nuk e bënë këtë, ose miratuan ndarjen e hapësirës sipas propozimit të dhe në përfitim të partive më të mëdha.²¹

MVZ i OSBE/ODHIR-it konstatoi përdorimin e automjeteve publike dhe të ndërtesave zyrtare për qëllime fushate nga dy partitë më të mëdha, gjë e cila ndalohet me ligj.²² Një sërë eventesh zyrtare qeveritare u shoqëruan me reklama dhe fjalime të fushatës së partisë në fuqi. Pati gjithashtu mbulim të fushatës në faqen zyrtare të internetit të Kryeministrit. Këto raste të zbehjes së vazhdueshme të kufijve midis institucioneve shtetërore dhe interesave partiake bien në kundërshtim me pikën 5.4 të Dokumentit të Kopenhagën të OSBE-së të vitit 1990 dhe pikën I.2.3 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias. Në 13 maj kryeministri nxori një urdher që i detyronte zyrtarët e lartë publikë të ndalonin përdorimin e fondeve dhe mjeteve publike për qëllime fushate, gjë që përforcoi dispozitat ligjore ekzistuese.

Pretendime të përhapura se punonjësve të sektorit publik u kërkohej nga shefat e tyre të merrnin pjesë në tubime zgjedhore apo të siguronin mbështetje për partinë në fuqi ndikuan negativisht në klimën para-zgjedhore.²³ Vëzhguesit e OSBE/ODHIR-it konstatuan raste specifike të shkollave që ishin të mbyllura gjatë tubimeve të zhvilluara gjatë orëve të mësimi, sepse mësuesit dhe nxënësit

¹⁸ Pati interpretime të kundërta midis palëve të interesit në lidhje me një dispozitë të re, Neni 175.2 i Kodit Zgjedhor në mënyrë të qartë detyron KQZ-ne të ri-ndisë listat e kandidatëve për të përmbushur kuotën gjinore. Grupet e shoqërisë civile kritikuan paaftësinë e KQZ-së për ta bërë këtë.

¹⁹ Hetimi i katër rasteve të mundshme që lidhen me zgjedhjet janë në vazhdim: një vrasje në tentativë i kryetarit vendor të PD-se në Komunën Shtiqen (Kukës); shpërthimi i një pajisjeje eksplozivive jashtë banesës së kandidatit të PD-së në Vlorë; rrahja e një kandidatit të FRD-së në Fier dhe rrahja e një anëtari të emëruar nga PS-ja në një KQV në Qarkun e Beratit.

²⁰ FRD-ja nuk u njoh zyrtarisht si parti parlamentare megjithëse kishte një anëtar në parlament.

²¹ Në Vlorë, kryetari i bashkisë nuk pranoi t'u japë kandidatit të pavarur si edhe Aleancës Kuq e Zi informacionin në lidhje me vendet dhe hapësirat e përcaktuara për fushatë. Në Shkodër, FRD-ja pretendoi se nuk pati mundësi që të organizonte një takim në sallën e teatrit lokal dhe të kishte mundësi të vendoste tabela promovuese.

²² Shembujt përfshijnë materiale të fushatës mbi autobusët publikë në Tiranë dhe Kamëz (për PD-në), në Gjirokastër (për PS-në) dhe në Delvine, Qarku Vlorë (për Partinë për Drejtësi, Integritim dhe Unitet (PDIU)) si dhe përdorimi i godinave të bashkive për qëllime fushate në Krujë (për PD-në), në Gramsh dhe Librazhd (për PS-në) dhe në Durrës (për PDIU dhe PD).

²³ Për shembull: në Laç (Lezhë) u raportua se një drejtor shkolle u pushua nga puna sepse nuk zbatoi urdhrin e shefit të tij për të dërguar mësuesit në tubimin e PD-së. Më 14 qershor, PS-ja bëri një kallëzim penal duke pretenduar që një drejtor në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë urdhëroi zyrtarisht me shkrim punonjësit e saj që të mblidhnin kontakte për votues të angazhuar të PD-së.

ishin të detyruar të merrnin pjesë në tubime.²⁴ PS pretendoi se aktivistët dhe mbështetësit e saj, duke përfshirë edhe anëtarët e KQV-ve të zgjedhjeve të mëparshme apo familjarët e tyre janë pushuar nga puna në sektorin publik për arsye politike. Në disa raste vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it vlerësuan se këto pretendime ishin të besueshme.²⁵ Këto veprime bien në kundërshtim me pikën 7.7 të Dokumentit të Kopenhagën të OSBE-së të vitit 1990 dhe pikën I.3.2 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias.²⁶

Vëzhguesit Ndërkombëtarë u informuan për pretendime për blerjen e votës, edhe nga dy partitë politike më të mëdha kundër njëra-tjetrës, akuza të cilat u vlerësuan si të besueshme dhe u intensifikuan në ditët para ditës së zgjedhjeve dhe njollosën klimën zgjedhore. Shumica e pretendimeve fokusoheshin mbi grupet në nevojë, veçanërisht në komunitetin Rom dhe komunitete të tjera më të varfra, sidomos në zonat rurale. Në shkëmbim të votës, thuhet se ofertat përfshinin para, mbulim të borxheve, të mira materiale ose punësim në sektorin publik.²⁷

Një vendim i KQZ-së mbi shpërndarjen e fondeve paradhënie nga buxheti i shtetit, për fushatën e kandidatëve në zgjedhje, u mor 11 ditë pas fillimit të fushatës zyrtare për shkak të një vendimi të marrë me vonesë nga parlamenti.²⁸ Financimet private të fushatës u lejuan me një kufizim prej 1 milionë lekë për financimet individuale dhe një kufizim të përgjithshëm jo më shumë se dhjetëfishi i shumës së dhuruar nga buxheti i shtetit. Kandidatët duhet të mbanin një regjistër të dhuruesve privatë dhe dhurimeve, por shpenzimet totale të fushatës duhet raportoheshin tek ekspertët kontabël të licencuar, emëruar nga KQZ-ja vetëm pas zgjedhjeve. Kuadri ligjor nuk parashikon transparencë të mjaftueshme në lidhje me raportimin e financimit të fushatës duke qenë se nuk ka kërkesa formale për publikim para ditës së zgjedhjeve. Një numër OJQ-sh shprehën shqetësim mbi shpenzimet e partive politike që tejkaluan kufizimet ligjore.

Media

Gjatë gjithë fushatës mjedisi i medias ishte i politizuar dhe ofroi një shumëllojshmëri këndvështrimesh në përmbajtje, që lejoi zgjedhësit të bëjnë një zgjedhje të ndërgjegjësuar. Megjithatë pavarësia editoriale u pengua nga ndikimet politike.

Media e transmetuar konsiderohet si burimi kryesor i informacionit për qytetarët, me një numër të madh mediash që operojnë në të gjithë vendin. Media e shkruar është gjithashtu e shumëllojshme, por ka qarkullim të kufizuar. Interneti përbën një hapësirë të gjerë për debate publike. Kodi Zgjedhor rregullon të gjitha transmetimet në media gjatë fushatës zgjedhore, duke përfshirë transmetimin e edicioneve informative, reklammat me pagesë dhe minutazhin e transmetimit falas.²⁹

Media e monitoruar nga MVZ-ja OSBE/ODIHR i ofroi një pasqyrim të gjerë zgjedhjeve në programe të llojeve të ndryshme, duke përfshirë 36 debate televizive ndërmjet përfaqësuesve të partive.³⁰ Transmetimet nga media e monitoruar, përgjithësisht, respektuan heshtjen zgjedhore prej 24 orësh para datës së zgjedhjeve. Televizioni publik *TVSH* i ofroi minutazh falas të gjithë

²⁴ Tubimi i PD-së në Kukës më 23 maj dhe tubimi i PS-së në Divjakë (Fier) më 8 qershor. Në këto tubime dhe në një sërë aktiviteteve të tjera të fushatës, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it konstatoi se deri në 30 përqind e pjesëmarrësve ishin nxënës shkollash.

²⁵ Shih Rubrikën mbi Ankimet dhe Apelimet.

²⁶ Paragrafi 7.7 parashikon fillimin e fushatës në një atmosferë ku zgjedhësit të mund të votojnë pa patur frikë nga ndëshkimi.

²⁷ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka marrë raporte të shumta mbi blerjen e votës nga të paktën shtatë qarqe dhe u njoftua për disa arrestime.

²⁸ Parlamenti shpërndau 65 milionë Lekë nga financimi publik i partive politike të fushatës zgjedhore.

²⁹ Në Kodin Zgjedhor nuk parashikohen rregulla për median e shkruar.

³⁰ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it monitoroi mbulimin politik në orarin e shikueshmërisë më të lartë në gjashtë kanale televizive (*TVSH*, *Top Channel*, *TV Klan*, *Vizion Plus*, *News24* dhe *Ora News*), si dhe në katër gazeta të përditshme (*Panorama*, *Shqip*, *Mapo* dhe *Shqiptarja.com*)

konkurruesve në përputhje me Kodin Zgjedhor. *TVSH-ja*, i ofroi pasqyrim të barabartë në lajme partive politike kryesore (40% PD-së, 6% qeverisë, 41% PS-së), megjithatë u pa një qasje më pozitive ndaj PD-së dhe qeverisë (45% për PD-në krahasuar me më pak se 1 përqind për PS-në), duke cënuar kështu detyrimin ligjor për paanshmëri. Të gjitha partitë e tjera politike patën një pasqyrim në lajme vetëm 13 përqind.

Ndërsa medias televizive iu kërkua t'iu ofronte partive parlamentare të cilat kanë marrë jo më pak se 20 për qind të vendeve në Kuvend gjysmën e kohës së vënë në dispozicion për partitë e mëdha, asnjë nga mediat e monitoruara nuk e përmbushi këtë detyrim.³¹ Dy partitë politike më të mëdha, tejkaluan kufirin prej 90 minutash të reklamave të paguara, duke shkelur ligjin.

Ndërsa televizionet private të monitoruara ishin të ndara. TV Klan i ofroi 53 përqind të mbulimit të lajmeve për PD-në (në të shumtën e rasteve me një qasje pozitive) dhe 28 përqind për PS-në (shpesh me qasje negative). Ndërsa, mbulimi i lajmeve nga Top Chanel dhe Vizion Plus, ishte relativisht i balancuar ndaj dy partive të mëdha, për qeverinë, mbulimi në lajme kishte me qasje negative. Kanalet televizive News 24 dhe Ora News, në përgjithësi ofruan mbulim të paanshëm për partitë kryesore. Për median e shkruar, monitorimi i mediave nga MVZ-ja OSBE/ODIHR-it, vuri re një polarizim të ngjashëm me gazetën Shqip dhe Shqiptarja.com, kryesisht duke favorizuar opozitën dhe gazeta Mapo dhe Panorama partinë qeverisëse. Monitorimi i medias nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, konstatoi se kandidatet femra patën mbulim shkajshëm në lajme (nga një deri në pesë përqind në kanalet televizive të monitoruara), duke reflektuar probleme të vazhdueshme në lidhje me pjesëmarrjen e femrave në jetën politike.

Bordi i Monitorimit të Medias (BMM) u krijua një muaj më pas afatit ligjor.³² Bordi paraqiti propozimet në KQZ sipas ndarjeve partiake, shfaqti mungesë kolegjaliteti dhe pavarësie.³³ BMM-ja nuk i paraqiti KQZ-së raporte ditore siç me kërkohet me ligj. Gjatë periudhës së fushatës, KQZ-ja shqyrtoi vetëm dy nga tre raportet javore të BMM-së, të cilat në disa raste përmbanin pasaktësi.³⁴ Mbikëqyrja e mbulimit të medias nga autoritetet kompetente mbeti problematike, veçanërisht përsa i përket mungesës së masave korrigjuese efektive dhe në kohën e duhur.³⁵ Megjithatë, asnjë media formale nuk paraqiti ankimet në KQZ.

Edhe pse ligji e ndalon, KQZ-ja nuk ndërpreu transmetimin e reklamave të financuara nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, Ministria e Drejtësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Shërbimi Postar Shqiptar, ku u promovuan arritjet e qeverisë. Këto reklama u transmetuan nga *TVSH-ja*, *TV Klan*, *News 24* dhe *Ora News*.

Më datën 3 qershor, KQZ-ja miratoi një vendim të debatueshëm pa u konsultuar me BMM-në, që nënkupton kërkesën për transmetuesit të transmetojnë gjatë edicioneve të tyre informative material mbi fushatën, të regjistruar paraprakisht nga subjektet zgjedhore.³⁶ Ky vendim çënoi rëndë lirinë editoriale, tejkaloi fuqinë rregullatore të KQZ-së dhe është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-

³¹ Në total, katër partitë më të vogla parlamentare patën 9 përqind të mbulimit me lajme në TVSH, 10 përqind në TV Klan, 16 përqind në Top Channel, 13 përqind në Vizion Plus, 17 përqind në News24 dhe 17 përqind në Ora News.

³² BMM-ja u ngarkua me monitorimin e medias dhe propozimin e sanksioneve administrative gjatë fushatës.

³³ BMM-ja arriti konsensusin vetëm për kompensimin e kohës televizive. Propozimet e tjera u firmosën nga katër anëtarë të propozuar nga shumica parlamentare ose nga tre anëtarë të propozuar nga opozita.

³⁴ Siç u vu në dukje nga KQZ-ja dhe nga vetë BMM-ja në 6 Qershor.

³⁵ Për shembull, KQZ-ja nuk mori asnjë vendim rreth propozimeve të bëra nga 3 anëtarët e BMM-së të propozuar nga opozita në lidhje me reklamën televizive të financuara nga institucionet publike.

³⁶ KQZ-ja shpërfilli një vendim të Kolegjit Zgjedhor të vitit 2011, i cili hodhi poshtë një vendim të mëparshëm të KQZ-së duke urdhëruar transmetuesit të transmetojnë regjistrime të përgatitura nga subjektet zgjedhore në rastet kur transmetuesit televizivë nuk mund të ofrojnë vetë mbulimin me lajme (shiko gjithashtu rubrikën mbi ankimet dhe kërkesëpaditë).

së dhe standardet e Këshillit të Evropës.³⁷ Ndërsa Kodi Zgjedhor i lejon subjektet zgjedhore të dorëzojnë materialet e tyre, transmetuesit nuk janë të detyruar t'i transmetojnë ato në edicionet informative. Si pasojë, e vendimit të KQZ-së, materialet e partive u përdorën gjerësisht nga transmetuesit, duke kufizuar kështu aksesin e shikuesve në raportime të pavarura.³⁸ Avokati i Popullit rekomandoi KQZ-në të shfuqizojë vendimin e saj.

Minoritetet Kombëtare

Në përgjithësi, minoritetet gëzojnë të drejtat e tyre. Kushtetuta garanton të drejta të barabarta për minoritetet kombëtare. Ndërsa, nuk gjenden të dhëna zyrtare të besueshme mbi minoritetet, besohet gjerësisht se komunitetet më të mëdha janë ato Greke dhe Rome. Minoritetet e vogla përfshijnë etni maqedonase, bullgare, serbe, malazeze, boshnjake dhe vllahe. Një numër partish politike iu drejtuan komuniteteve minoritare në platformat e tyre. PBDNJ-ja dhe Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, u fokusuan kryesisht mbi minoritetin Grek. Aleanca Maqedonase për Integrimin Evropian dhe Partia për Tolerancë Kombëtare u fokusua mbi etninë Maqedonase dhe votimin e minoriteteve Rome dhe Egjiptiane. Ligji, në reklamën televizive, nuk lejon gjuhë të tjera, përveç gjuhës shqipe, e cila nuk është interpretuar me qëllim përfshirjen e reklamave të fushatës zgjedhore.³⁹ Në të kundërt, të gjithë subjektet zgjedhore zhvilluan fushatë të lirë në gjuhën e tyre të parapëlqyer. Çështjet specifike të minoriteteve janë trajtuar rrallë nga fushatat e partive politike, me përjashtim të partive minoritare. Disa drejtues të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane konstatuan se një numër zgjedhësish nga komunitetet e tyre nuk ishin të pajisur me karta identiteti.

Ankimet dhe kërkesëpaditë

Palëve të interesit nuk iu siguroa në mënyrë të mjaftueshme masa korigjuese, efikase ligjore dhe proces i rregullt ligjor për zgjidhjen e ankesave, në kundërshtim me pikën 5.10 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 dhe paragrafit II.3.3 të Kodit të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore, të Komisionit të Venecias. Në çështje të rëndësishme, institucionet gjyqësore refuzuan të shqyrtonin ankime ose tejkaloan juridiksionin e tyre. Për më tepër, subjektet zgjedhore, rrallëherë përdorën mekanizmat e zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve zgjedhore, duke përfshirë një mungesë besimi të raportuar në administratën zgjedhore, gjykatat dhe institucionet e zbatimit të ligjit.

Ankimet kundër vendimeve të KQZ-së mund të paraqiten në Kolegjin Zgjedhor, i cili ka një afat 10 ditor për të gjykuar dhe për të dhënë një vendim.⁴⁰ Sipas Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore, të Komisionit të Venecias, ky është një afat papërshtatshëm i gjatë në një periudhë para zgjedhore, i cili sipas disa partive politike i ka penguar ato të paraqesin ankime.⁴¹ E drejta e

³⁷ Përfshirë edhe paragrafin 9.1 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990, paragrafin 26 të Dokumentit të Takimit të Moskës të vitit 1991 dhe paragrafin 1.3 të Rekomandimeve të KE-së dhe rek të KM-së (2007) në të cilin thuhet se “Kornizat rregullatore për mbulimin e zgjedhjeve nga ana e medias duhet të respektojnë pavarësinë editoriale të medias”.

³⁸ Rastet e kasetave të përgatitura nga partitë politike të transmetuara si lajme në mediat lokale u raportuan gjithashtu edhe nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it në Shkodër, Durrës, Tiranë, Elbasan dhe Korçë.

³⁹ Në kundërshtim me paragrafin 32.5 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990: “personat që i përkasin minoriteteve kombëtare kanë të drejtë të [...] shpërndajnë, të kenë akses dhe të shkëmbejnë informacion në gjuhën e tyre kombëtare”.

⁴⁰ Kolegji Zgjedhor i përbërë nga tetë gjyqtarë të përzgjedhur me llotari nga Gjykata e Apelit përpara çdo zgjedhjeje kombëtare, mandati i të cilëve është i kufizuar vetëm me gjykimin e ankimeve kundër KQZ-së. Gjatë periudhës para zgjedhore, Kolegji Zgjedhor gjykoi 15 ankime; 8 prej tyre kishin të bënin me regjistrimin e partive, 6 me administrimin e zgjedhjeve, 1 me kundërshtimin e gjobës për mosrespektimin e kuotave gjinore.

⁴¹ Shiko paragrafin II.3.3.g të Kodit të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias në të cilin thuhet që “afatet kohore për paraqitjen dhe marrjen e vendimeve në apel duhet të jetë i shkurtër (tre deri në 5 ditë për çdo rast në shkallën e parë).

partive politike që secila të kundërshtonte një gjyqtar të Kolegjit Zgjedhor u shfuqizua në vitin 2012, duke rritur pavarësinë e këtij organi. Të gjitha vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë të formës së prerë, megjithëse Kushtetuta garanton të drejtën për apelim gjyqësor.

Për më tepër, ndërsa Gjykata Kushtetuese ka detyrimin sipas nenit 131.f të Kushtetutës të rishikojë vendime gjyqësore të formës së prerë në mënyrë që të sigurojë përputhjen me garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, ajo refuzoi juridiksionin për të rishikuar vendime të Kolegjit Zgjedhor në lidhje me respektimin e këtij parimi. Vetëm konkurruesit kanë të drejtë të bëjnë ankim kundër institucioneve të administratës zgjedhore. Zgjedhësit, grupet e qytetarëve dhe OJQ-të nuk mund të kundërshtojnë vendime administrative ose veprime të tjera që mund të ndikojnë mbi votimin e tyre ose të drejtat publike zgjedhore, duke iu mohuar një korrigjim efektiv në procesin zgjedhor.⁴² Edhe zbatimi nga KQZ i neneve mbi kuotat gjinore dhe rregullimi i detyrimeve të transmetuesve të medias nuk mund të kundërshtohen në gjykatë nga grupet e interesuara.

PS bëri ankim në Gjykatën Kushtetuese duke kundërshtuar kushtetutshmërinë e vendimit të parlamentit në lidhje me ndarjen e mandateve. PS argumentoi se parlamenti nuk ishte ligjërishit i mandatar të merrte një vendim pa një propozim të KQZ-së dhe se mosaplikimi statistikave në lidhje me shpërndarjen e popullsisë ka shkelur të drejtën e votës së barabartë. Gjykata refuzoi juridiksionin në lidhje me këtë çështje pa një bazë të shëndoshë ligjore. Sipas gjykatës ankuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike. Megjithatë, vendimet e parlamentit nuk rishikohen nga Kolegji Zgjedhor ose nga ndonjë gjykatë tjetër.

Mosmarrja e një vendimi nga KQZ në lidhje me numrin e ZAZ-ve u kundërshtua në Kolegjin Zgjedhor. Në vendimin e tij, Kolegji Zgjedhor krijoi një numër të ZAZ-ve, në kundërshtim me nenin 145.2, sipas të cilit Kolegji Zgjedhor duhet të urdhëronte KQZ-në për të vendosur në lidhje me numrin e ZAZ-ve. Në dy çështje në lidhje me vendndodhjen e paligjshme të QV-ve dhe KQV-ve, Kolegji Zgjedhor zgjodhi vendndodhje të reja në vend që të dërgonte çështjen përsëri në KQZ për të marrë një vendim të ri. Kolegji Zgjedhor mori përsipër përgjegjësitë administrative të KQZ-së, gjë që nuk është në përputhje me procedurat e parashikuara nga ligji. Mënyra se si këto vendime u trajtuan *de facto* nuk mundëson rishikim efikas ligjor.

Megjithatë, partitë kanë ngritur akuza në lidhje me shkeljen e fushatës, veçanërisht presionin e ushtruar mbi nëpunësit civilë, mekanizmat në lidhje me ankimet përgjithësisht nuk u përdorën.⁴³ Sipas Avokatit të Popullit qytetarët rrezikonin të humbnin punën ose pasoja të tjera në qoftë se bënë ankim në lidhje me presionin politik.⁴⁴ KQZ është përgjegjëse për mbikëqyrjen e përputhshmërisë me Kodin Zgjedhor, duke përfshirë dhe ndalimet administrative të keqpërdorimit të burimeve shtetërore. Megjithatë, kur përfaqësuesi pa të drejtë vote i PS-së në KQZ paraqiti një ankim në lidhje me shkarkimin nga detyra të dy mësuesve për arsye të refuzimit për të marrë pjesë në fushatën e PD-së, kryetarja e KQZ-së refuzoi të hapë një debat në lidhje me çështjen.⁴⁵

⁴² Zgjedhësit mund të apelojnë vetëm kundër përjashtimit nga regjistri i zgjedhësve dhe grupet e shoqërisë civile mund të apelojnë vetëm kundër vendimeve që i refuzojnë atyre akreditimin si vëzhgues për zgjedhjet.

⁴³ PS-ja në një rast bëri kallëzim penal duke i kërkuar prokurorisë që të akuzojë drejtuesit e mësuesve bazuar në Nenin 328 të Kodit Penal. Ky nen është shtuar në Mars të 2012-ës, i cili parashikon si krim, detyrimin e qytetarëve për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës.

⁴⁴ Avokati i Popullit ngriti një grup pune për çështjet që lidhen me zgjedhjet dhe u kërkoi publikisht nëpunësve publike ndaj të cilëve ushtrohej presion për të bërë ankime si edhe i bëri rekomandime kryeministrit, kryetarëve të bashkive dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës duke u kërkuar që të nxjerrin urdhra që ndalojnë pjesëmarrjen e nëpunësve publike dhe të fëmijëve të shkollave në aktivitetet e fushatës gjatë orarit të punës dhe të mësimit.

⁴⁵ Nuk është dorëzuar asnjë ankim zyrtar tek KQZ-ja në periudhën parazgjedhore.

Vëzhguesit Vendorë dhe Ndërkombëtarë

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar. Vëzhguesit vendorë emërohen nga OJQ-të. Organizatat e vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë, si edhe konkurruesit kanë të drejtë të vëzhgojnë të gjithë aspektet e procesit zgjedhor. Partitë politike që konkurrojnë në mënyrë të pavarur dhe kandidatët e pavarur mund të caktojnë nga një vëzhgues për qendër votimi dhe nga një për tavolinën e numërimit të votave. Koalicionet mund të caktojnë tre vëzhgues për qendër votimi dhe tavolinë të numërimit të votave. Vëzhguesit vendorë nuk kanë të drejtë të marrin kopje të Procesverbaleve për Mbylljen e Votimit dhe të tabelës përmbledhëse të rezultateve, apo të paraqesin ankime që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

KQZ-ja ka akredituar 8,421 vëzhgues vendorë nga 44 organizata dhe 789 vëzhgues ndërkombëtarë. Një numër grupe vëzhguesish vendorë u angazhuan në vëzhgim afat-gjatë dhe nxorën raporte gjatë gjithë procesit.

Dita e Zgjedhjeve, Numërimi dhe Nxjerrja e Rezultateve

Në përgjithësi, dita e zgjedhjeve u zhvillua në mënyrë të rregullt. Gjithsesi, një përplasje e dhunshme, në mëngjes, jashtë qendrës së votimit në Laç (Qarku Lezhë), çoi në vdekjen e një mbështetësi të një partie dhe në plagosjen e dy të tjerëve, përfshirë këtu dhe një kandidat. Ndërsa kjo dhe raste të tjera të izoluara dhune, njollosën fillimin e zgjedhjeve, dita e zgjedhjeve përgjithësisht u zhvillua në mënyrë paqësore. KQZ-ja hodhi në faqen e saj të internetit rezultatet paraprake, edhe pse jo të përditësuara rregullisht ndërsa zhvillohej numërimi.

Përgjithësisht, hapja u vlerësua pozitivisht në 89 përqind të 122 QV-ve të vëzhguara, dhe negativisht në 16 përqind, gjë e cila konsiderohet e rëndësishme. Vëzhguesit raportuan një vonesë në hapjen në 72% të QV-ve të vëzhguara, për arsyet që përfshijnë mungesë organizimi, debateve mbi procedurat, mbërritja me vonesë e anëtarëve të KQV-ve apo mungesa e materialeve të tilla si bojë apo fletë votimi.⁴⁶ Vonesa prej më shumë se gjysmë ore, u raportuan në 15 raste. Në 12 raste të vëzhguara, libri i protokollit të vulave nuk ishte depozituar në kutitë e fletëve të votimit përpara fillimit të votimit, siç përcaktohet nga ligji. Vëzhguesit e kandidatëve dhe grupet e vëzhguesve vendorë u konstatuan që ishin të pranishëm, përkatësisht në 87 dhe 35 përqind të qendrave të votimit.

Votimi u vëzhgua në 1,363 QV. Nga këto, 94 përqind u vlerësuan si mirë ose shumë mirë dhe 6 përqind si keq. Vetëm shtatë QV të vëzhguara u vlerësuan si shumë keq. Tregues të tejmbushjes të mundshme të kutive të fletëve të votimit u vëzhguan në tre QV.⁴⁷ Raste të votimit familjar/në grup u vëzhguan 14 përqind të QV, dhe më shpesh në zonat rurale. Votimi në emër të tjetrit u vëzhgua në 5 përqind të QV-ve. Në 3 përqind të QV-ve, një person u vëzhgua duke asistuar shumë zgjedhës, dhe në 3 përqind, një person u vëzhgua që përpiqej të ndikonte tek zgjedhësit për kë të votonin. Votimi më shumë se një herë u vëzhgua në 12 QV.⁴⁸ Përgjithësisht, vëzhguesit dhanë më tepër vlerësim negativë në zonat rurale (10 përqind) krahasuar me zonat urbane (3 përqind).

Vëzhguesit e kandidatëve ishin të pranishëm në 89 përqind dhe vëzhguesit vendorë në 22 përqind të QV-ve të vëzhguara, duke përmirësuar transparencën. Megjithatë, ndërhyrje në votim të vëzhguesve të kandidatëve u vëzhguan në 8 përqind të QV-ve. Ata të cilët ndërhyrën në të njëjtën

⁴⁶ QV-ja 2547, KZAZ-ja 46 (Cërrik, Qarku Elbasan) në hapje të votimit nuk kishte fletë votimi. Fletët e votimit rezervë mbërritën vetëm në 12:30, ku më pas filloi votimi.

⁴⁷ U vëzhguan në kutinë e votimit të QV-së 4190 në ZAZ-në 77 (Përmet, Qarku Gjirokastrë), QV 1942 në ZAZ-në 37 (Qarku Tiranë), dhe QV 31 92 në ZAZ-në 59 (Qarku Fier) fletë votimi të hedhura në mënyrë jo rastësore.

⁴⁸ Në QV-në 2955, KZAZ 57 (Lushnje, Qarku Fier) në 15 raste votimi u vëzhgua votimi më shumë se një herë.

mënyrë përfaqësonin të dy koalicionet e kryesuar nga PD-ja dhe PS-ja. Verifikimi i bojës, një nga disa prej garancive kundër votimit të shumëfishtë, ishte midis parregullsive të vëzhguara më shpesh dhe që nuk u krye në vazhdimësi në 28 përqind të QV-ve të vëzhguara. Vëzhguesit ndërkombëtarë ishin të pranishëm në 9 nga 20 burgje, ku ishin ngritur QV-të dhe në të gjitha rastet vlerësuan procesin e votimit pozitivisht.

Mbyllja e qendrave të votimit dhe dërgimi i materialeve u vëzhgua në 93 të rasteve dhe u vlerësua si mirë ose shumë mirë në 79 raste, dhe si keq në 6 raste. Shumica e QV-ve u mbyllën në kohë me vetëm 12 raste të mbylljeve të votimit me 15 minuta më vonë; tre nga këto u mbyllën një orë më vonë. U konstatuan disa parregullsi, kryesisht për shkak të pasigurisë mbi procedurat. Numrat e vulave të kutive të votimit, në 10 raste nuk u protokolluan saktësisht dhe kopjet e procesverbaleve të mbylljes së votimit, jo gjithmonë iu jepeshin atyre që kanë të drejtën (në 12 raste të vëzhguara). Nga të gjitha, vetëm tetë raste të vëzhguara, materialet mbërritën në VNV-të brenda tre orëve, afat i përcaktuar.

Në bazë të 82 raporteve nga 73 nga 89 VNV-të, vëzhguesit vlerësuan materialet e marra si mirë apo shumë mirë në të gjitha rastet, përveç një rasti. Procesi, përgjithësisht ishte transparent, edhe pse disa raste në aktivitete pati shumë njerëz, gjë e cila u vëzhgua në 15 raste. Deri më tani, vëzhguesit kanë raportuar se vetëm gjashtë kuti me materiale zgjedhore u deklaruan 'të parregullta'. Në një sërë VNV-sh, grupet e numërimit nuk ishin ngritur ende ose vazhdonin të trajtoheshin gjatë marrjes së kutive të fletëve të votimit, që shkaktoi vonesa në fillimin e numërimit. Vonesa të njëpasnjëshme në procesin e numërimit u konstatuan në vendet ku grupet e numërimit pushuan gjatë.

Në kohën që po hartohej kjo deklaratë, në vendet ku numërimi kishte filluar, ky i fundit u vlerësua pozitivisht. Procedurat mbi vlefshmërinë e fletëve të votimit, përgjithësisht janë ndjekur dhe rezultatet vazhdimisht hidhen në tabelën përmbledhëse të rezultateve. Në disa raste, vëzhguesit janë vendosur shumë larg nga tavolina e numërimit për një vëzhgim korrekt, duke reduktuar transparencën e përgjithshme.

*Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.
Një përkthim jo-zyrtar ekziston në shqip.*

INFORMACION PER MISIONIN DHE FALENDERIME

Tiranë 24 qershor 2013 - MVZ i OSBE/ODIHR-it filloi aktivitetin e tij në Tiranë më 15 maj. Ky mision përfshin 15 ekspertë në kryeqytet dhe 30 vëzhgues afatgjatë në të gjithë Shqipërinë.

Më shumë se 387 vëzhgues nga 43 shtete u dërguan në terren, në ditën e zgjedhjeve nga OSBE/ODIHR-i, ku përfshiheshin 316 vëzhgues afat-gjatë dhe afat-shkurtër, si edhe 48 parlamentarë dhe punonjës nga AP e OSBE-së, dhe 23 anëtarë nga APKE. Procesi i votimit u vëzhgua në rreth 1,400 nga 5,508 qendra votimi në të gjithë vendin. Numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultateve u vëzhgua në 66 Vende të Numërimit të Votave.

Vëzhguesit dëshirojnë të falënderojnë autoritetet e Republikës së Shqipërisë për ftesën për të vëzhguar zgjedhjet, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për bashkëpunimin dhe përgatitjen e dokumenteve të akreditimit, dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe autoritete të tjera për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. Vëzhguesit dëshirojnë gjithashtu t'i shprehin mirënjohjen, ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare të akredituara në Shqipëri për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi të kontaktoni:

Conny McCormack, Drejtuese e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it në Tiranë (+ 355697364951)
Thomas Rymer, Zëdhënës i OSBE/ODIHR-it (+48609522266) ose
Steven Martin, Këshilltar për Çështjet Zgjedhore të OSBE/ODIHR-it në Varshavë (+4822 520 0600)
Roberto Montella, AP e OSBE-së, (+355 697366674) ose (+43 699 10 42 86 81)
Bogdan Torcatoriu, i APKE-së (+355 68 692 7879) ose (+33 650 39 29 40)

Adresa e MVZ-së i OSBE/ODIHR-it:

Rr. Brigada VIII, Nd. 10, 1019
Tirana, Republika e Shqipërisë
Tel: +355-4-226 89 66, Faks: +355-4-226 8955
Email: office@odihr.al